



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Komuna Rahovec - Opštine Orahovac

Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë - Sektori për pronë

Odeljenje za Katastar, Geodeziju i Imovinu - Sektor za imovinu

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOSOVA
OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

III- Nr. i prot. 2428 Më 08.07.2022
Br. prot. Dt.

Datë/a	18.06. 2022	RAHOVEC - ORAHOVAC
Referencë/a		
Për/Za?To :	Z. Smajl Latifi - Kryetar i K. Rahovec	
CC:	Z. Fatmir Iska Nënkyetar i K. Rahovec	
Përmes/Prekp/Through:	Drejtëpërdrejt	
Nga/Od/From :	Z. Afrim Oruqi Jurist i Diplomuar Drejtë i Drejtëorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	
Subjekt/Subekat/Subject:	Raporti gjasht mujor i punës i vitit 2022	

Raporti gjasht mujor i punës i vitit 2022

Nga: Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

Fillimi i vitit të ri është karakterizuar me qasje në detyrat e reja dhe obligimet e mbetura nga viti paraprak.

Qysh në fillim të vitit 2022 i jemi qasur punës në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara nga Kryetari i Komunës në përputhje me Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Statutin e Komunës së Rahovecit dhe Planin e Punës për Vitin 2022.

Gjatë periudhës gjasht mujore për të cilën po raportojmë, të tre sektorët e Drejtëorisë i kanë përfunduar këto punë:

Sektori:	Lëndët:	Shuma €
Kadastër dhe Pronë	213	3,710 €
Gjeodezi	1,300	2,320 €
Referenti	1,170+62 L.Z.	3,915 €
Totali	2,683+62 L.Z.	9,945 €

Gjatë periudhës gjasht mujore Janar- Qershor i kemi përfunduar këto punë:

Pranimi i aplikacioneve të qytetarve dhe të gjeodetve privat për ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, regjistrim i pjesës së ndarjes, regjistrim të hipotekave, cregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje, ndërrim i paluajtshmëris, ndarje e bashkësis familjare etj.

Kërkesa për certifikatat e pronës dhe kopje plani.

Barazimi financiar me drejtorin e financave për muajin Janar- Qershor të vitit 2022.

Pranimi i lëndëve për ndarje fizike, produkte si koordinata, modifikime dhe punë tjera të cilat janë kryer nga sektori i gjeodetve.

Pergjigje në kërkesat e përfaqësuesit ligjor të Komunës në lidhje me shënimet sipas lëndëve në procedur gjyqësore dhe padive.

Me kërkesë të qytetarve për shpronësim të pronës private- rrugë e kalueshme në terren ZK Rahovec kemi dalë në terren me gjeodet dhe kemi përgatitur Historiat të parcelave në fjalë. Sipas afatit lëndë i kemi pranuar dhe aprovaur me kohë në intranet, gjatë javës së dyt të muajit janar kemi pranur dy kërkesa për fajle të pronës private në pronë publike për hapje të rrugës, gjeodet kanë dalë në terren janë kufizuar parcelat në fjalë dhe janë marë deklarata nga palë për falje të pronës.

Gjatë javës së tretë të janarit kemi vlersuar punëtor në afat ligjor për vitin 2021. Kemi evidentuar të gjitha pronat që janë në territorin e komunës së Rahovecit e që jan në menaxhim të AKP-së dhe kemi përgatitur një raport të detajuar për secilen parcel, zonë dhe sipërfaqe të pronave. Kemi pranuar kërkesë nga drejtoria e ekonomis për evidentimin e pronave në disa zona si Krushë e Madhe, Ratkoc dhe Xërxë për caktimin e lokacioneve për zonat e vogla ekonomike.

Kemi publikuar në afat ligjor listën e pergjithshme të pronave dhe listen e veqant të pronave të cilat planifikojm për dhënie me qira ne nivel komune brenda vitit 2022.
Kemi mbajtur takimet e rregullta me Agjencionin Kadastral të Kosovës.
Pergjigje në kërkesat e zyres ligjore sipas nevojës.

Kemi pranuar kërkesa nga keshillat e fshatrave për kufizime të rrugëve, varrezave, pronave publike dhe parcelave tjera si në ZK Guri i Kuq, Senoc, Rahovec etj. Një punëtor administrativ nga sektori i kadastrit e kemi bartur me zyre në katin e parë të administratës dhe nga kjo javë ofrohen produktet për qytetar si certifikatat e pronës, evidentimi i parcelave dhe shërbime tjera edhe në katin e parë të administratës.
Gjatë javës së katërt të janarit kemi evidentuar të gjitha pronat që janë në territorin e komunës së Rahovecit e që janë në menaxhim të Agjencionit Pyjor të Kosovës dhe kemi përgatitur një raport të detajuar për secilën parcel, zonë dhe sipërfaqe të pronave.

Me kërkesë nga keshilli i fshatit Guri i Kuq kemi dalë në terren me gjeodet dhe kemi kufizuar parcelën me nr. 01126-0 rrugë. Përgjigje në kërkesat e Avokatit të Komunës në lidhje me shënimet sipas lëndëve në procedur gjyqësore.

Me kërkesë nga drejtoria e arsimit kemi dalë në terren me gjeodet dhe kemi kufizuar parcelën në ZK Rahovec dhe kemi përgatitur dokumente si: situacionin e terrenit, certifikatën e pronës dhe kopjen e planit për parcelën ku ideohet të ndërtohet cerdhja e fëmijëve. Kemi përfunduar evidentimin e pronave që menaxhohen nga Agjencioni Pyjor i Kosoves ne nivel Komune.
Sipas planit të Kuvendit Komunal kemi përgatitur material të nevojshëm për Komitetin për Politik dhe Financa. Takim me zyrtar të AKP-së në Prizren. Përfundimi i Historiateve të parcelave sipas kërkesës zyrtare.

Gjatë javës së tretë të Shkurtit kemi përfunduar Historiatin e parcelave në ZK Rahovec te stacioni i autobusave dhe e kemi kufizuar parcelën sipas kërkesës së drejtoris së Ekonomis. Me kërkesë të inspektoratit kemi dalë në terren me gjeodet dhe zyrtar të pronës e kemi inqizuar parcelen dhe objektin në ZK Rahovec kemi nxjerr vendim dhe janë njoftuar palë në procedurë. Kemi përgatitur një raport detal me pronat komunale në 34 Zona Kadastrale në nivel të komunës. Kemi pranuar kërkesë nga keshilli i fshatit Senoc për dalje në terren dhe kufizim të parcelës në ZK Senoc.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastrë dhe Pronë ka përfunduar raportin detal me prona të uzurpuara publike në 34 Zona Kadastrale në nivel të Komunës. Me kërkesën tonë kemi nënshkruar marrëveshje me AKK-në në Prishtinë në lidhje me shërbimet e Koposit. Përgjigje në afat ligjor kërkesave të qytetarve. Takim i rregullt me zyrtar të Agjencionit në lidhje me lëndë që janë kontestuese. Sipas kërkesës së keshillit të fshatit Senoc kemi dalë në terren dhe kemi kufizuar parcelën sipas kërkesës. Kemi pranuar kërkesë nga inspektorati për dalje në terren në ZK Dabidol për konstatim se a ka uzurpim të pronës publike në parcelën në fjalë.

Kemi pritur në takim përfaqësues të AKK-së ku së bashku me Kryetarin e Komunës Z. Latifi kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për sistemin e adresave REGIP.
Me kërkesa zyrtare kemi dalë në terren dhe kemi kufizuar varrezat e fshatit Senoc, stacionin e autobusave në qytet, dalje në terren me kërkesë të inspektoratit, kufizimi i parcelës në Hoqë të Vogël, dalje në terren dhe kufizimi i rrugve fushore sipas kërkesës së drejtoris së bujqësis etj.
Pregatitje e materialit të nevojshëm për Komitetin për Politik dhe Financa.

Dhe punë tjera sipas kërkesave të palëve.

Me respekt,

Afrim Oruqi

Drejtore i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Komuna Rahovec

Mob: +377 (0) 45 134 006

Ctx: +381 (0) 3820045311

afrim.oruqi@rks-gov.net

